



PRISHTINA

	
NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A. GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D. MPE "BUS STATION" J. S.	
Nr. 02/11464 No.	Data 10.08.2026 Date
PRISHTINË/A	



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, si dhe në bazë të dispozitave përkatëse të Statutit në fuqi të NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë, Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më 10.08.2026, pas shqyrtimit të ankesës së kandidatit z. Bislim Hajdari, me nr. prot. 02/1429, të datës 04.08.2026, të paraqitur brenda afatit të përcaktuar, merr këtë:

V E N D I M

(Për anulimin e Konkursit Publik për Pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv)

- I. **ANULOHE**T në tërësi Konkursi Publik me nr. prot. 02/1128, të datës 23.06.2026, për plotësimin e pozitës së punës Kryeshef Ekzekutiv i NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë.
- II. **OBLIGO**HET Administrata e Ndërmarrjes që t'i njoftojë me shkrim të gjithë kandidatët aplikues për anulimin e Konkursit Publik me nr. prot. 02/1128, të datës 23.06.2026, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes.
- III. Procedura e re e rekrutimit për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv do të zhvillohet përmes një konkursi të ri publik, në pajtim me legjislacionin në fuqi, Statutin e ndërmarrjes dhe aktet e tjera të brendshme përkatëse.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Bordi i Drejtorëve, në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Statutin e NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë, ka shqyrtuar ankesën e kandidatit z. Bislim Hajdari, të paraqitur më 04.08.2026, me nr. prot. 02/1429, në lidhje me procedurën e Konkursit Publik nr. 02/1128, të datës 23.06.2026, për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv.

Ankesa është paraqitur brenda afatit të përcaktuar dhe, si e tillë, është marrë në shqyrtim nga Bordi i Drejtorëve.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të ngritura në të, Bordi ka vlerësuar rregullsinë e procedurës së zhvilluar në kuadër të konkursit dhe përputhshmërinë e saj me dispozitat ligjore, Statutin e ndërmarrjes dhe aktet e brendshme obligative.

Nga shqyrtimi i çështjes, Bordi ka konstatuar se në fazën fillestare të procesit të përzgjedhjes nuk është zbatuar një nga kërkesat procedurale të përcaktuara me aktet e brendshme obligative të ndërmarrjes.

Konkretisht, sipas Seksionit II, Pikës 3(a)-(iv) të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative të NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë, parashihet që Bordi i Drejtorëve të udhëzojë një këshilltar të pavarur, kompetent dhe me reputacion, për të vlerësuar kandidatët kundrejt kërkesave minimale dhe për të krijuar listën e ngushtë.

Nga procedura e zhvilluar rezulton se këshilltari i pavarur i paraparë me këtë dispozitë nuk është angazhuar, ndërsa vlerësimi fillestar dhe krijimi i listës së ngushtë janë zhvilluar pa përfshirjen e këtij mekanizmi procedural.

Bordi vlerëson se moszbatimi i kësaj kërkesë nuk përbën vetëm një mangësi formale, por paraqet një parregullsi procedurale që prek drejtpërdrejt fazën e vlerësimit fillestar të kandidatëve dhe krijimit të listës së ngushtë.

Kjo parregullsi ndikon në garantimin e objektivitetit, paanshmërisë dhe transparencës së procesit dhe, rrjedhimisht, cenon integritetin e procedurës së përzgjedhjes.

Në këtë drejtim, Bordi vlerëson se procedura e zhvilluar nuk i ka përmbushur në tërësi kërkesat procedurale të përcaktuara me aktet obligative të ndërmarrjes dhe se parregullsia e konstatuar prek një fazë thelbësore të procesit të përzgjedhjes.

Duke pasur parasysh se parregullsia e konstatuar lidhet me fazën fillestare të vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, Bordi vlerëson se ajo nuk mund të korrigjohet në mënyrë adekuate vetëm përmes vazhimit të procedurës nga faza e intervistimit, pasi një veprim i tillë do të mund të cenonte barazinë e trajtimit të kandidatëve dhe integritetin e procesit.

Për rrjedhojë, vazhdimi i Konkursit Publik me nr. prot. 02/1128, të datës 23.06.2026, do të krijonte pasiguri juridike dhe procedurale lidhur me vlefshmërinë e fazave të zhvilluara deri në këtë moment.

Për të garantuar zhvillimin e një procedure të re të ligjshme, transparente, të paanshme dhe të bazuar në meritë, Bordi vlerëson se anulimi në tërësi i konkursit dhe zhvillimi i një procedure të re nga fillimi paraqet masën e përshtatshme për eliminimin e parregullsive të konstatuara.

Duke u bazuar në sa më sipër, si dhe në kompetencat ligjore dhe statutare të Bordit të Drejtorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të kërkojë mbrojtje gjyqësore pranë gjykatës kompetente, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve
Shaban BRAHIMAJ

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Prishtinë

